FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.27 29 shkurt 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9875 datë 14.2.2008	Për metrologjinë ……	1261
Ligj nr.9876 datë 14.2.2008	Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport ..	1281
Ligj nr.9877 datë 18.2.2008	Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë	1288

LIGJ
Nr.9875, datë 14.2.2008

PËR METROLOGJINË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon sistemin kombëtar të metrologjisë në Shqipëri dhe kërkesat për të kryer veprimtaritë në metrologjinë shkencore, industriale dhe atë ligjore.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim të realizojë:

a) zhvillimin e sistemit kombëtar të metrologjisë, në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe me nevojat kombëtare;

b) njohjen ndërkombëtare të rezultateve të matjeve kombëtare dhe të etaloneve kombëtare të matjeve;

c) lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, nëse këto instrumente kanë shenjën e miratimit të tipit dhe të verifikimit fillestar ose, në mungesë të këtij të fundit, lejimin për hedhjen në treg ose vënien në shërbim të tyre;

ç) lëvizjen e lirë të produkteve të parapaketuara, nëse ato kanë shenjën e konformitetit dhe harmonizimin e metodave për matjet dhe kontrollin metrologjik;

d) mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Instrument matës” është çfarëdo pajisje apo sistem me funksione matëse.
2. “Metrologji” është shkenca e matjeve.
3. “Metrologji shkencore” është ajo pjesë e metrologjisë, e cila merret me realizimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e etaloneve kombëtare të matjeve.
4. “Metrologji industriale” është pjesë e metrologjisë, me të cilën realizohet krahasimi i rezultateve të matjes.
5. “Metrologji ligjore” është pjesë e metrologjisë, e cila rregullohet me ligj dhe dispozita të tjera, për sigurimin e saktësisë dhe të besueshmërisë në rezultatet e matjes në fushat ku aplikohen instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara.
6. “Matje” është seria e veprimeve për përcaktimin e vlerës së një madhësie.
7. “Njësi matjeje” është madhësia e caktuar, e pranuar me marrëveshje, për të shprehur në mënyrë sasiore madhësi të tjera të së njëjtës natyrë.

8. “Tipi i instrumentit matës” është një seri instrumentesh matëse, me funksion identik, bazuar në të njëjtin parim, që kanë të njëjtin projekt dhe që janë prodhuar nga i njëjti prodhues, në bazë të të njëjtit dokumentacion teknik dhe teknologjik.

9. “Etalon matjeje” është masë matjeje, instrument matës, material referues ose sistem matës i paracaktuar që të përcaktojë, të realizojë, të ruajë ose të riprodhojë një njësi ose më shumë vlera të një madhësie, për t'i transmetuar ato, me anë të krahasimeve, me instrumente të tjera matëse.

10. “Etalon kombëtar i matjeve” është një etalon i deklaruar nga Këshilli i Ministrave për të shërbyer në Republikën e Shqipërisë si një bazë për përcaktimin e vlerave të etaloneve të tjera të madhësisë përkatëse.

11. “Etalon referues” është një etalon që, përgjithësisht, ka cilësinë më të lartë metrologjike në një vend apo organizatë të dhënë, nga i cili rrjedhin matjet e bëra.

12. “Ruajtje e etalonit të matjes” janë të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur karakteristikat metrologjike të etalonit të matjes, brenda kufijve të caktuar.

13. “Material referues” është një material mjaftueshmërisht homogjen dhe i qëndrueshëm, për një apo më shumë cilësi, i përdorur në kalibrim, për përcaktimin e vlerës së një materiali tjetër ose për sigurimin e cilësisë.

14. “Material referues i certifikuar” është një material referues, i shoqëruar me dokumentacionin e lëshuar nga organizma autoritarë dhe në përputhje me procedurat e vlefshme, të përdorura për të shtuar vlera cilësore specifike me pasiguri dhe transmetueshmëri (gjurmueshmëri).

15. “Transmetueshmëri (gjurmueshmëri)” është cilësia e rezultatit të matjes ose vlera e etalonit të matjes, e arritur pas një serie zinxhiri krahasimesh me etalonet e përcaktuara të matjes, ndërkombëtare ose kombëtare, që kanë të gjitha një pasiguri dhe nivel besueshmërie të përcaktuar.

16. “Kalibrim” është tërësia e veprimeve që përcakton, në kushte të veçanta, marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga një instrument ose sistem matës, ose të vlerave të dhëna nga një masë materiale, si dhe të vlerave të njohura, korresponduese të instrumentit të matur.

17. “Verifikim” është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.

18. “Verifikim i rregullt i një instrumenti matës” është një verifikim i kryer periodikisht dhe në përputhje me rregullat.

19. “Verifikim jashtë radhe i instrumentit matës” është një verifikim i kryer pas rimodelimit, eliminimit të mosfunksionimeve ose defekteve të tjera teknike (riparim) apo i kryer jashtë periudhës së verifikimit.

20. “Autorizim” është dhënia e së drejtës për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve publike dhe private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

21. “Certifikim” është veprimtaria, nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces apo shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimet metodike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ose në përputhje me standardet e përcaktuara.

22. “Parapaketim” është kombinimi i një produkti dhe një paketimi individual. Një produkt është i paketuar, kur ai vendoset në parapaketim të çfarëdo natyre qoftë, pa qenë blerësi prezent dhe sasia e produktit, që përmbahet në parapaketim, ka një vlerë të paracaktuar dhe nuk mund të ndryshohet pa u hapur parapaketimi ose pa iu nënshtruar një modifikimi të perceptueshëm.

23. “Shishe, si enë matëse” është çfarëdo kontejneri i bërë prej qelqi ose ndonjë materiali tjetër, që ka një fortësi dhe qëndrueshmëri të tillë, për të ofruar të njëjtat garanci metrologjike si qelqi, i taposur apo i projektuar për t'u taposur, që destinohet për magazinim, transport ose shpërndarje të lëngjeve e që ka karakteristika metrologjike (karakteristika të projektimit dhe uniformitet të prodhuesit) të tilla, që mund të përdoren si shishe matëse, kur ato mbushen deri në një nivel specifik ose një përqindje të specifikuar të kapacitetit të tyre deri në buzë dhe përmbajtja e tyre mund të matet me një saktësi të mjaftueshme dhe që ka kapacitet nominal nga 0,05 deri në 5 litra brenda.

24. “Inspektim” është shqyrtimi i një produkti, shërbimi, procesi ose sistemi matës, me anë të përcaktimit të përputhjes së tyre me kërkesat specifike ose në bazë të një gjykimi profesional, me kërkesa të përgjithshme.

25. “Matje zyrtare” është një matje e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar (më poshtë ekzekutues i matjes zyrtare), në përputhje me vendimin

administrativ për autorizim. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në procedurat dhe vendimmarrjet e organizmave qeveritarë apo të gjykatave.

26. “Miratim i tipit të instrumenteve matëse” është pranimi i këtyre instrumenteve për verifikim fillestar dhe, kur kjo e fundit nuk kërkohet, autorizimi për t'i hedhur ato në treg dhe/ose për t'i vënë në shërbim.

27. “Verifikim fillestar i instrumenteve matëse” është kontrolli i një instrumenti të ri apo të riparuar dhe vërtetimi i përputhjes së instrumentit matës me tipin e miratuar.

28. “Lejim për hedhje në treg ose vënie në shërbim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara” është leja e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për hedhjen në treg ose vënien në shërbim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat nuk kanë shenjën e verifikimit fillestar.

Neni 4
Fushat e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen në ato instrumente matëse, që përdoren për matje në transanksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 5
Vënia në dispozicion të publikut e rezultateve të matjeve

Rezultatet e matjeve, të kryera me kërkesë të organizmave qeveritarë ose që i shërbejnë nevojave të organizmave qeveritarë dhe që kanë lidhje me transaksionet zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit, duhet të vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

KREU II
ORGANIZIMI I SISTEMIT KOMBËTAR TË METROLOGJISË

Neni 6
Sistemi kombëtar i metrologjisë

Sistemi kombëtar i metrologjisë përbëhet nga:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;

b) laboratorët e etaloneve kombëtare;

c) laboratorët e kalibrimit;

ç) laboratorët e testimit;

d) organizmat certifikues, që merren me certifikimin e materialeve referuese në fushën e metrologjisë;

dh) personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për të kryer detyra të metrologjisë ligjore, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 7
Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik, publik, i specializuar për metrologjinë, me qendër në Tiranë dhe e organizuar në qendra rajonale, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Juridiksioni i ushtrimit të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë është i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, ndërsa për qendrat rajonale territori përcaktohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme e Metrologjisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Rekrutimi i nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

4. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka këto detyra e të drejta për metrologjinë:

1. Propozon strategjinë e zhvillimit të metrologjisë dhe, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, ndjek zbatimin e saj nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Studion dhe propozon përmirësime të legjislacionit për metrologjinë, të cilat ia paraqet ministrit përgjegjës për ekonominë.

3. Bashkërendon punën me organizmat e tjerë të sistemit kombëtar të metrologjisë dhe mbështet zhvillimin e këtij sistemi kombëtar.

4. I propozon ministrisë përgjegjëse për ekonominë deklarimin e mbajtësve të etaloneve kombëtare të matjeve.

5. Mban dhe ruan disa nga etalonet kombëtare të njësive të matjes në laboratorët e saj.

6. Monitoron mënyrën e mbajtjes, të ruajtjes dhe të përdorimit për të gjitha etalonet kombëtare të matjeve.

7. Monitoron përdorimin e fondeve shtetërore, për financimin e etaloneve kombëtare të matjeve në institucionet e tjera publike dhe private.

8. Certifikon materialet referuese.

9. Kryen kontrollin ligjor të instrumenteve matëse.

10. Kryen kontrollin sasior të produkteve të parapaketuara dhe të shisheve, si enë matëse.

11. Përcakton procedurën e mbajtjes së regjistrit të prodhuesve dhe të importuesve të parapaketimeve dhe shisheve, enë matëse.

12. Autorizon persona juridikë për verifikimin e mjeteve matëse, ekspertizën metrologjike, si dhe persona fizikë apo juridikë për riparimin e instrumenteve matëse.

13. Realizon inspektimin metrologjik.

14. Kryen mbikëqyrjen e tregut të instrumenteve matëse, të prodhuara në vend dhe/ose të importuara, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

15. Sanksionon rregullat dhe mënyrën për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të saj dhe ofron kualifikime për çështje të metrologjisë për specialistët e tjerë të subjekteve private dhe publike.

16. Bashkëpunon me institucionet e tjera, veçanërisht me ato të infrastrukturës kombëtare të cilësisë dhe institucionet e mbrojtjes së konsumatorit.

17. Shërben si referencë kombëtare për sistemin kombëtar të akreditimit të laboratorëve të kalibrimit, për aftësitë dhe etalonet e matjeve.

18. Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të metrologjisë.

19. Bashkëpunon me organizmat kombëtarë të metrologjisë të vendeve të tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë në veprimtarinë e fushës përkatëse, rajonale apo ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe.

20. Ofron këshillime për problemet që kanë lidhje me legjislacionin për metrologjinë.

21. Kryen verifikimin periodik të lojërave të fatit.

Neni 9

Detyrat e institucioneve kryesore

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, që kanë në varësi laboratorë matjeje, mbështesin veprimtarinë e strukturave, që kanë në varësi, për të siguruar transmetueshmëri (gjurmueshmëri), saktësi dhe besueshmëri në procesin e matjeve.

Neni 10
Këshilli i metrologjisë

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë krijohet dhe funksionon këshilli i metrologjisë, i cili është organ këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtij organi përcaktohen me urdhër ministrit përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm kësaj drejtorie.

KREU III
NJËSITË E MATJES

Neni 11

Në Republikën e Shqipërisë do të përdoret Sistemi Ndërkombëtar i Njësive të Matjes (SI) .

Këshilli i Ministrave bën përcaktimin e njësive të tjera jashtë sistemit SI dhe përcakton përdorimin e njësive jashtë sistemit SI, kur ato përdoren ndërkombëtarisht dhe nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga sistemi SI.

KREU IV
METROLOGJIA SHKENCORE DHE INDUSTRIALE

PJESA I
METROLOGJIA SHKENCORE

Neni 12
Etalonet kombëtare të matjeve

1. Mbajtësit e etaloneve kombëtare të matjeve deklarohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

2. Etalonet kombëtare të matjeve duhet të jenë të transmetueshme (gjurmueshme) me etalonet ndërkombëtare.

3. Jo çdo madhësi fizike duhet të ketë etalonin kombëtar të matjeve të deklaruar.

4. Etalonet kombëtare të matjeve zhvillohen dhe mirëmbahen në laboratorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Për ato madhësi fizike që kjo drejtori nuk ka kapacitete matjeje, etalonet kombëtare zhvillohen dhe mirëmbahen në institucione të tjera publike apo private.

5. Zhvillimi, mirëmbajtja dhe njohja ndërkombëtare e etaloneve kombëtare të matjeve paraqesin interes të veçantë për Republikën e Shqipërisë dhe mbështeten nga fondet e Buxhetit të Shtetit.

6. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për:

a) kushtet që duhet të plotësojë një etalon referues për t'u deklaruar si etalon kombëtar matjeje;

b) kushtet për anulimin e deklarimit dhe arsyet;

c) mirëmbajtjen e detyrueshme dhe përdorimin e etaloneve kombëtare të matjeve.

Neni 13
Laboratorët e etaloneve kombëtare

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe personat juridikë e fizikë që zhvillojnë, mirëmbajnë dhe përdorin etalonet kombëtare të matjeve, kryejnë detyrat e laboratorit të etaloneve kombëtare për madhësinë përkatëse, si më poshtë:

a) sigurimin e transmetueshmërisë (gjurmueshmërisë) së etaloneve kombëtare të matjeve me njësitë SI;

b) përhapjen e njësive të etaloneve kombëtare të matjeve tek etalonet referuese të matjeve dhe të instrumenteve matëse me anë të kalibrimit;

c) sigurimin e njohjes ndërkombëtare të etaloneve kombëtare të matjeve dhe të certifikatës të kalibrimit të lëshuar;

ç) ndërmarrjen e masave për ruajtjen e transmetueshmërisë (gjurmueshmërisë), në rastin e dëmtimit dhe të shkatërrimit të etaloneve kombëtare të matjeve.

2. Aftësia teknike e laboratorëve të etaloneve kombëtare të matjeve ruhet nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtaritë metrologjike ndërkombëtare dhe provohet me akreditim apo në një mënyrë tjetër të barasvlefshme.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë bashkërendon veprimtaritë e laboratorëve të etaloneve kombëtare të matjeve drejt njohjes ndërkombëtare.

4. Marrëdhëniet ndërmjet laboratorëve të etaloneve kombëtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe personave juridikë apo fizikë rregullohen me kontratë.

5. Laboratorët e etaloneve kombëtare duhet t'i dërgojnë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë të dhëna për veprimtaritë me etalonet kombëtare të matjeve, përfshi edhe të dhënat për përdorimin e fondeve buxhetore në bazë të kontratës së hartuar mes tyre.

PJESA II
METROLOGJIA INDUSTRIALE

Neni 14
Transmetueshmëria (gjurmueshmëria) e matjeve

Transmetueshmëria (gjurmueshmëria) e mjeteve matëse sigurohet me anë të kalibrimit ose me materialet referuese të certifikuara.

Neni 15
Kalibrimi i etaloneve të matjes dhe instrumenteve matëse

1. Kalibrimi kryhet në përputhje me dokumentet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë.

2. Kalibrimi i etaloneve të matjeve dhe instrumenteve matëse kryhet në laboratorët e kalibrimit, me kërkesën e përdoruesit.

3. Aftësia teknike e laboratorëve të kalibrimit provohet me akreditim.

Neni 16
Certifikimi i materialeve referuese

1. Certifikimi i materialeve referuese është një procedurë, që vendos një apo më shumë cilësi të vlerave të një materiali ose substance, me një proces që siguron transmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) ndaj Sl-së. Cilësitë e vendosura të vlerave dhe pasiguritë shoqëruese të matjeve paraqiten në një certifikatë.

2. Certifikimi i materialeve referuese kryhet në përputhje me procedurat e miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

3. Testimi i cilësive të materialeve referuese kryhet nga laboratorët e testimit.

4. Certifikimi i materialeve referuese kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe organizma të tjerë certifikimi, të përcaktuar sipas dispozitave në fuqi.

5. Aftësia teknike e laboratorëve të testimit të materialeve referuese dhe të organizmave të certifikimit provohet me akreditim.

Neni 17
Detyrat e laboratorëve të etaloneve kombëtare për të mbështetur transmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) e matjeve

1. Laboratorët e etaloneve kombëtare ofrojnë kalibrime të etaloneve referuese të matjeve të

laboratorëve të kalibrimit me kërkesën e tyre.

2. Laboratorët e etaloneve kombëtare sigurojnë vlerat referuese të njësive respektive të matjeve për krahasimet ndërlaboratorike, të organizuara për laboratorët e kalibrimit.

KREU V
METROLOGJIA LIGJORE

PJESA I

Neni 18
Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Sipas këtij ligji, instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara janë instrumentet matëse që përdoren në:

a) transanksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik dhe sigurinë;

b) kontrollin e produkteve të parapaketuara dhe shisheve, si enë matëse;

c) matjet e përshkruara nga ky ligj dhe rregulla të përshtatura për zbatimin e tyre.

2. Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, ashtu si dhe përbërësit e tyre, pajisjet shtesë dhe pajisjet ndihmëse, i nënshtrohen kontrollit metrologjik, që kryhet nëpërmjet miratimit të tipit, verifikimit fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për kërkesat teknike dhe metrologjike, për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 19
Hedhja në treg dhe/ose vënia në përdorim e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara mund të hidhen në treg dhe/ose të vihen në përdorim, nëse janë testuar sipas një procedure të përshkruar, përputhen me rregullat metrologjike dhe kanë shenjat verifikuese të përshkruara.

2. Instrumentet matëse, që janë hedhur në treg dhe/ose janë vënë në shërbim, në përputhje me rregulla të tjera, mund të përdoren në metrologjinë ligjore, nëse ato kanë kaluar procedurat e përshkruara të vlerësimit të konformitetit, plotësojnë kërkesat thelbësore të përshkruara dhe kanë shenjën e përshkruar të përputhjes, me të cilën një prodhues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar (më poshtë referuar si furnitor) garanton se instrumentet matëse përputhen me kërkesat metrologjike të përshkruara.

Neni 20
Përdorimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, që janë përdorur në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duhet të përputhen me tipin e miratuar dhe/ose kërkesat teknike dhe metrologjike të jenë verifikuar dhe të kenë të fiksuara shenjat e vlefshme të përshkruara.

2. Një instrument matës ligjërisht i kontrolluar, që nuk është në përdorim, duhet të jetë i markuar, në mënyrë të dukshme, me shenjën “instrument matës jashtë përdorimit”.

3. Personat juridikë dhe fizikë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, duhet të përdorin instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara, në mënyrë që të sigurojnë saktësinë e kërkuar të matjeve. Ata janë përgjegjës për performancën teknike të instrumenteve matëse dhe për saktësinë e rezultateve të matjeve.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përshkruan markimin e instrumenteve matëse, që nuk përdoren më në metrologjinë ligjore.

Neni 21

Detyrimet e përdoruesve të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në përdorim

Përdoruesi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara duhet që:

a) të përdorë instrumente matëse të verifikuara;

b) t'i mirëmbajë ato në kushte teknike, që sigurojnë saktësinë e matjeve;

c) t'i verifikojë sipas këtij ligji dhe rregullave të përshtatura për zbatimin e tij;

ç) t'i përdorë sipas qëllimit të tyre;

d) të mbajë regjistrime për mirëmbajtjen dhe verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në përdorim, kur kështu është e përshkruar.

Neni 22

Miratimi i tipit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë miraton tipin e instrumentit matës, kur ky plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike, të përshkruara në rregulloren e Këshillit të Ministrave, për kërkesat teknike dhe metrologjike, për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, sipas pikës 3 të nenit 18 të këtij ligji.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë merr vendim për refuzimin apo heqjen e instrumentit matës, kur ky instrument nuk plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të kërkuara, të përcaktuara për një procedurë testimi.

3. Kundër vendimit për refuzimin ose heqjen e instrumentit matës mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

4. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr një rregullore për miratimin e tipit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 23

Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Nëse është përcaktuar, nëpërmjet procedurave testuese të përshkruara, se instrumenti matës ligjërisht i kontrolluar përputhet me tipin e miratuar dhe plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të përshkruara, një metrolog i autorizuar e verifikon atë.

2. Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara mund të jetë fillestar, periodik, i kryer në intervale specifike dhe jashtë radhe.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar është i detyruar të lëshojë certifikatën e verifikimit me kërkesën e aplikantit, edhe nëse instrumenti matës ka të fiksuar tashmë shenjën e verifikimit.

4. Instrumentet matëse, që nuk janë subjekt i verifikimit, duhet të mirëmbahen rregullisht. Procedura, përmbajtja dhe intervalet, kur kryhet mirëmbajtja e rregullt, rekomandohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

5. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr një rregullore për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 24

Mbarimi i vlefshmërisë së verifikimit

Verifikimi i një instrumenti matës ligjërisht të kontrolluar nuk është i vlefshëm nëse:

a) ka mbaruar periudha e verifikimit;

b) instrumenti matës i nënshtrohet një modifikimi, që ndikon në karakteristikat e tij metrologjike;

c) instrumenti matës është dëmtuar në një mënyrë të tillë, që ai humbet disa karakteristika të

tij thelbësore të verifikimit të mundshëm ose qëllimin e tij të përdorimit;

ç) shenja e verifikimit është shkatërruar;

d) është e qartë se instrumenti matës ka humbur karakteristikat metrologjike të kërkuara, megjithëse shenja e verifikimit nuk është dëmtuar;

dh) vendi i instalimit të instrumentit matës është ndryshuar.

Neni 25

Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar

1. Instrumentet matëse, që janë me tip të miratuar, i nënshtrohen verifikimit fillestar, vetëm nëse është përshkruar ndryshe.

2. Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar është përgjegjësi e furnitorit. Verifikimi fillestar ka të bëjë me kontrollin e instrumentit matës të ri ose të riparuar dhe vërtetimin e përputhshmërisë së tij me tipin e miratuar. Ky instrument matës ligjërisht i kontrolluar certifikohet me shenjën e verifikimit fillestar.

3. Kur instrumenti matës i nënshtrohet verifikimit fillestar, kontrolli duhet të përcaktojë nëse:

a) instrumenti i përket një kategorie të përjashtuar nga tipi i miratuar dhe, në këtë rast, nëse përmbush kërkesat teknike dhe funksionale;

b) instrumenti matës është i tipit të miratuar dhe në përputhje me të.

4. Instrumentet matëse, që janë hedhur në treg, i nënshtrohen verifikimit fillestar, kur përdoren në metrologjinë ligjore.

Neni 26

Verifikimi pasardhës i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Verifikimi periodik i instrumenteve matëse bëhet në intervale verifikimi të përshkruara për tipe të ndryshme instrumentesh matëse.

2. Verifikimi periodik i instrumenteve matëse është përgjegjësi ligjore e përdoruesit/pronarit të tij.

3. Verifikimi periodik i instrumenteve matëse, si matësit e ujit të ngrohtë apo të ftohtë, matësit e energjisë elektrike dhe të gazit janë përgjegjësi ligjore e personave juridikë apo fizikë, që shesin ujin e ftohtë apo të ngrohtë, gazin dhe energjinë elektrike.

4. Verifikimi jashtë radhe i instrumenteve matëse kryhet kur ky instrument nuk ka qenë në përdorim për prishje apo defekte të tjera teknike ose nuk është verifikuar brenda periudhës së përshkruar të verifikimit.

Neni 27

Vendi i verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar kryejnë verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në kushtet e veta dhe në vendet e verifikimit.

2. Vendi i verifikimit është vendi jashtë kushteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose të një personi juridik të autorizuar, ku këto të fundit kryejnë verifikimin e një tipi të veçantë instrumenti matës ligjërisht të kontrolluar, duke përdorur pajisjet e përshkruara, që i përkasin kësaj drejtorie, personit juridik të autorizuar, përdoruesit të instrumentit matës apo shërbimit të autorizuar.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar kryen verifikimin e instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në vendet ku janë vendosur, ndërfutur apo instaluar instrumentet matëse, në rastet kur një instrument matës ligjërisht i kontrolluar, për shkak të konstruksionit, është i lidhur me vendin e instalimit, ose në raste të instrumenteve matëse që, për shkak të konstruksionit të tyre, mund të dëmtohen apo thyhen gjatë transportit.

4. Kur kryhet verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, sipas pikës 3 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar mund t'i kërkojë kërkuesit numrin e duhur të personelit ndihmës dhe pajisje verifikuese.

Neni 28
Shenjat (markimet) e verifikimit

1. Shenjat e verifikimit, të përdoruara në Republikën e Shqipërisë, janë shenjat shtetërore të verifikimit për verifikimin fillestar dhe atë pasardhës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përcakton tipin, formën dhe fiksimin e shenjave të verifikimit, të përdorura për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së verifikimit.

Neni 29
Përdorimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të riparuara

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përcakton se:

a) një instrument matës i riparuar mund të përdoret brenda një periudhe së shumti 30-ditore, duke filluar nga dita që ai është riparuar ose përgatitur për verifikim;

b) një person i autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike përgatit si duhet instrumentin matës për verifikim, e teston dhe mbron nga ndërhyrja e paautorizuar, nëpërmjet markimit me shenjën e verifikimit të shërbimit të autorizuar.

2. Personi i autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike riparimi duhet të bëjë menjëherë një kërkesë për verifikimin e instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, të riparuar, i cili është shenjuar me shenjën e verifikimit të personit të autorizuar.

Neni 30
Etalonet e matjeve dhe materialet referuese në metrologjinë ligjore

1. Për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara duhet të përdoren vetëm etalone matjeje të kalibruara, që kanë certifikatë kalibrimi të vlefshme dhe materiale referuese të certifikuara, që kanë certifikatë materiali referues të vlefshëm.

2. Kalibrimi i etaloneve të matjeve dhe certifikimi i materialeve referuese, që përdoren për verifikimin e instrumenteve ligjërisht të kontrolluara, kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, organizma të tjerë certifikimi, laboratorë kalibrimi të akredituar dhe laboratorë testimi të akredituar.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rekomandon intervalet e kalibrimit për etalonet e matjes, që përdoren për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 31
Certifikatat dhe shenjat e konformitetit të instrumenteve matëse, të lëshuara jashtë shtetit

1. Republika e Shqipërisë njeh certifikatat dhe shenjat e konformitetit, të lëshuara jashtë vendit, nëse ato janë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë mund të pranojë raportet e testimit dhe të verifikimit, nëse ato janë lëshuar sipas kërkesave të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë mban një regjistër të certifikatave, shenjave të konformitetit, të lëshuara në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 32
Verifikimi i sistemeve matëse

1. Verifikimi periodik dhe jashtë radhe i sistemeve matëse përfshin verifikimin e një instrumenti matës ligjërisht të kontrolluar e të një pjese përbërëse të sistemit, si dhe verifikimin e

sistemit si i tërë.

2. Pjesët e sistemit, që nuk ndikojnë në performancën metrologjike të sistemit, përjashtohen nga kontrolli metrologjik.

3. Verifikimi i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, si pjesë e sistemit matës dhe verifikimi i sistemit matës si i tërë është përgjegjësi e përdoruesit/pronarit të sistemit matës.

Neni 33
Pajisje me funksione matëse

Pajisjet me funksione matëse, që janë ekzaminuar, testuar dhe vlerësuar, në përputhje me rregulla të tjera, janë subjekt i dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të përshtatura për zbatimin e tij, që rregullojnë trasmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) e etaloneve të matjeve, materialeve referuese dhe të rezultateve të matjeve.

PJESA II
EKSPERTIZA METROLOGJIKE

Neni 34

1. Veprimtaritë e ekspertizës metrologjike janë: testimi i jashtëzakonshëm i instrumenteve matëse dhe matjet zyrtare.

2. Personat fizikë apo juridikë kanë të drejtë të kërkojnë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar.

3. Kostot që dalin gjatë testimit të jashtëzakonshëm të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara do të paguhen nga:

a) kërkuesi, në rastin kur instrumenti ka shenjën e verifikimit të vlefshme dhe nga testimi rezulton në përputhje me kërkesat metrologjike;

b) përdoruesi i instrumentit matës, kur nga testimi rezulton jo në përputhje me kërkesat metrologjike.

4. Personi juridik i autorizuar, për të bërë matje zyrtare, harton një raport testimi për rezultatet e matjes.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përshkruan përmbajtjen dhe procesin e një ekspertize metrologjike, në të dy komponentët e saj.

PJESA III
PARAPAKETIMET DHE SHISHET

Neni 35
Parapaketimet e kontrolluara ligjërisht

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në parapaketimet njëshe, të kombinuara, pa ambalazh mbështjellës dhe në enë matëse, që janë prodhuar, hedhur në treg ose ofruar për shitje te një blerës i panjohur.

2. Mostrat e lira, disa nga parapaketimet e destinuara, të përdorura në aeroplane, anije dhe trena dhe produktet në kontejnerë, që janë përgatitur për konsumatorin e fundit, në bazë të një kontrate të ndërsjellë, nuk vlerësohen parapaketime, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë rregulloren për parapaketimet, ku përshkruhen:

a) kriteret, parimet kryesore dhe masat e përgjithshme për parapaketimet;

b) parapaketimet që kontrollohen ligjërisht;
c) kërkesat metrologjike për sasinë neto të parapaketimeve;
ç) diapazonet e detyrueshme për sasinë nominale të disa parapaketimeve;
d) metodat referuese për kontrollin e sasisë neto të parapaketimeve;
dh) mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në parapaketime.

Neni 36
Shishet, si enë matëse, ligjërisht të kontrolluara

1. Sipas këtij ligji, shishe, si enë matëse, është një enë prej qelqi ose ndonjë materiali tjetër, që ruan formën e saj të pandryshueshme, në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkruara, kapaciteti nominal i të cilave është nga 0,05 - 5 litra, përfshirë dhe këto dy vlera.

2. Shishet, si enë matëse, duhet të pajisen me shenja që tregojnë vëllimin nominal dhe atë të mbushjes deri në buzë, si dhe me shenjën që identifikon prodhuesin e enës matëse.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë rregulloren për shishet, si enë matëse, ku do të përshkruhen:
a) shishet, që kontrollohen ligjërisht;
b) kërkesat metrologjike për shishet, si enë matëse;
c) metodat referuese për kontrollin e vëllimit neto të shisheve;
ç) mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në shishet, si enë matëse.

Neni 37
Hedhja në treg e parapaketimeve dhe e shisheve

1. Mallrat e paketuara dhe shishet, si enë matëse, mund hidhen në treg dhe të ofrohen për shitje, vetëm nëse plotësojnë kërkesat metrologjike të përshkruara dhe kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara deri në kohën e blerjes.

2. Prodhuesi ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e produkteve të paketuara dhe të shisheve me masat e përcaktuara në këtë ligj.

3. Prodhuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të sasisë neto të paketimeve ose sistemin e kontrollit të vëllimit neto të shisheve të prodhuara.

4. Prodhuesi ose importuesi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, kur vihet re se parapaketimet ose shishet e hedhura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat, është i detyruar të marrë masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 38
Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve

Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve bëhet në bazë të kërkesës së tyre nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, sipas kërkesave dhe procedurave të miratuara nga ministri përgjegjës për ekonominë. Prodhuesit dhe importuesit detyrohen të njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për çdo ndryshim të kryer pas regjistrimit.

Neni 39
Miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë kryen vëzhgimin në vend të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve, që kanë bërë kërkesë për miratim, si dhe monitoron sistemin e kontrollit sasior të miratuar në kushtet e prodhuesit dhe, në qoftë se është e nevojshme, jep rekomandime për përmirësimin e tij.

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë nuk e miraton ose miraton pjesërisht sistemin e kontrollit sasior të prodhuesit, nëse ai nuk mirëmbahet si duhet.

Regjistrimi i prodhuesve bëhet dhe ruhet vetëm nëse sistemi i tij i kontrollit sasior është miratuar.

PJESA IV
DHËNIA E AUTORIZIMIT

Neni 40
Autorizimi i personave juridikë dhe fizikë për të kryer veprimtari në metrologjinë ligjore

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë jep autorizimin, në përputhje me këtë ligj dhe me rregulloret e nxjerra në zbatim të tij.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të autorizojë një person juridik, që plotëson kushtet e përshkruara, për të realizuar verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara dhe ekspertizën metrologjike, kur kjo drejtori nuk ka mundësi t'i realizojë këto detyra.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të autorizojë një person juridik apo fizik për shërbimin e riparimit të instrumenteve matëse. Shërbimi i riparimit të këtyre instrumenteve është i ndaluar të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe personi i autorizuar për verifikimin e instrumenteve matëse.

4. Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë të nxjerrë rregullore për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse.

Neni 41
Vendimi për autorizim

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë vendos për dhënien e autorizimit brenda 60 ditëve nga aplikimi.

2. Vendimi për autorizim përcakton qëllimin e autorizimit.

3. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë cakton markimin (shenjën) verifikuese të një personi të autorizuar për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 42
Revokimi i vendimit për autorizim

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të revokojë autorizimin ose ta reduktojë afatin e tij kur:

a) nuk plotësohen kushtet, për të cilat është dhënë autorizimi dhe nuk kryhen detyrat në mënyrën e përshkruar;

b) cenohen rëndë detyrimet e caktuara në këtë ligj dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij;

c) mbajtësit të autorizimit i kanë ndodhur ndryshime, që e bëjnë të pamundur respektimin e kushteve, për të cilat është dhënë autorizimi.

2. Personi juridik dhe fizik, autorizimi i të cilit është revokuar, sepse ai ka vepruar kundër rregullave, në mënyrë joprofesionale, si dhe në kundërshtim me sa parashikohet në autorizim, nuk mund të aplikojë për një autorizim të ri, brenda një periudhe prej tre vjetësh nga dita që i është revokuar autorizimi.

Neni 43
Pavlefshmëria e autorizimit

Autorizimi bëhet i pavlefshëm kur:

a) mbaron afati i vlefshmërisë;

b) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ka nxjerrë vendim për revokimin e autorizimit;

c) i autorizuari heq dorë, me shkrim, nga autorizimi.

Neni 44
Publikimi i vendimit për autorizim

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nxjerr dhe publikon buletinin zyrtar metrologjik me afat 3-mujor.

2. Vendimi për autorizim, ndryshimi i autorizimit dhe mbarimi i vlefshmërisë së tij publikohen në buletinin zyrtar metrologjik.

Neni 45
Detyrimet e personit të autorizuar

1. Një person juridik apo fizik i autorizuar duhet:

a) të kryejë veprimtarinë e tij profesionalisht dhe në përputhje me rregullat e vendimet për autorizim;

b) të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për mbarimin e autorizimit ose për ndonjë ndryshim të kushteve të autorizimit;

c) të mbajë dokumentacion të formave të ndryshme për problemet administrative, që lidhen me qëllimin e autorizimit, në përputhje me rregullat, nëse nuk përshkruhet ndryshe nga ky ligj, ose me rregullat e përshtatura për zbatimin e tij;

ç) të japë te Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë informacion të domosdoshëm, brenda afateve të caktuara të përshkruara dhe sipas procedurave të përshkruara, për regjistrimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në regjistrin përkatës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përshkruan afatet e caktuara dhe procedurat për dhënien e informacionit për instrumentet matëse të verifikuara.

Neni 46
Metrologu i autorizuar

1. Metrologu i autorizuar kryen verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

2. Metrologu i autorizuar është një punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose personi juridik i autorizuar, që plotëson kushtet e përshkruara për një metrolog të autorizuar.

3. Ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, përcakton kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati, për t'u kualifikuar si metrolog i autorizuar.

KREU VI
INSPEKTIMI METROLOGJIK

Neni 47
Inspektimi metrologjik

Për të kontrolluar (inspektuar) zbatimin e dispozitave detyruese të këtij ligji dhe të rregulloreve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe veprimtarinë e metrologëve të autorizuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë organizohet dhe funksionon Drejtoria e Inspektimit Metrologjik, e përbërë nga specialistë të kësaj drejtorie, të cilët pajisen me një dokument të posaçëm identifikimi dhe quhen inspektorë metrologë.

Neni 48
Plani vjetor i punës

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë miraton planin vjetor të punës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë i raporton ministrit përgjegjës për ekonominë për punën e inspektimit metrologjik, ku i paraqet masat e propozuara për përmirësimin e veprimtarive metrologjike.

Neni 49
Të drejtat e inspektorit metrolog

1. Gjatë inspektimit, inspektori metrolog ka të drejtë të hyjë dhe të inspektojë ndërtesat dhe kushtet e biznesit, ku prodhohen, magazinohen ose përdoren instrumente matëse, si dhe pajisjet, pajisjet e prodhimit dhe makinat. Gjithashtu, gjatë inspektimit, një inspektor metrolog ka të drejtë të hyjë dhe të inspektojë ndërtesat dhe kushtet e biznesit, ku janë prodhuar, importuar dhe ofruar për shitje produktet e parapaketuara dhe shishet, enë matëse.

Gjithashtu, ai ka të drejtë të inspektojë dokumentacionin e biznesit, të çfarëdo forme, për veprimtarinë metrologjike, regjistrimet dhe raportet e testimit të një personi juridik dhe fizik të autorizuar, ose të një metrologu të autorizuar, për të parë se si janë kryer këto veprimtari.

2. Gjatë inspektimit, inspektori metrolog është i autorizuar të kërkojë dhe të inspektojë dokumentet (kartë identiteti, pasaportë etj.), në bazë të të cilave përcaktohet identiteti i personit që inspektohet, i cili është i detyruar t'i vërë ato në dispozicion.

3. Një person juridik dhe fizik i autorizuar dhe persona të tjerë juridikë apo fizikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i inspektimit, janë të detyruar ta ndihmojnë inspektorin metrolog për të kryer inspektimin dhe t'i japin atij të dhënat dhe informacionet e domosdoshme. Me kërkesë me shkrim të inspektorit, për të realizuar detyrat e tij, personat juridikë dhe fizikë që inspektohen janë të detyruar të japin ose të përgatisin, brenda një periudhe të caktuar, të dhëna të plota dhe të sakta, informacione dhe regjistrime të nevojshme për kryerjen e inspektimit.

4. Gjatë inspektimit, një inspektor mund të marrë dëshmi nga përfaqësuesit e personit juridik apo fizik dhe dëshmitarët.

5. Për inspektimin e kryer, inspektori metrolog mban një akt inspektimi, ku pasqyrohen të dhënat e marra. Ky akt inspektimi mbahet në dy kopje, njëra prej të cilave i lihet subjektit të inspektuar.

Neni 50
Detyrat e inspektorit metrolog

1. Gjatë inspektimit metrologjik, një inspektor metrolog verifikon:

a) ligjshmërinë dhe aftësinë në kryerjen e veprimtarive metrologjike;

b) përdorimin e njësive ligjore të matjeve;

c) ligjshmërinë dhe autoritetin ligjor në kryerjen e certifikimit të instrumenteve matëse, ekzaminimin e tipit të instrumenteve matëse dhe verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara;

ç) përdorimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara;

d) konformitetin e parapaketimeve dhe shisheve, enë matëse me masat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij;

dh) ligjshmërinë dhe aftësinë në punë të personave juridikë apo fizikë të autorizuar për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

e) mënyrën se si mbahen dhe përdoren regjistrimet dhe dokumentet e përshkruara;

ë) probleme të tjera kryesore për përcaktimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë dhe të aftësisë në punë, si dhe për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë ligj.

2. Në rastet kur inspektori metrolog vëren shkelje të këtij ligji dhe të rregulloreve të miratuara:

a) urdhëron korrigjimin e parregullsive dhe të mangësive të vërejtura brenda një periudhe kohe të specifikuar;

b) pezullon përdorimin e instrumenteve matëse dhe hedhjen në treg të paketimeve, që nuk përputhen me kërkesat e përshkruara;

c) pezullon kryerjen e veprimtarive, që janë në kundërshtim me ligjin apo me rregullat e zbatuara;

ç) pezullon punën e një personi të autorizuar dhe fillon procedurën për refuzimin, revokimin e autorizimit, kur ky nuk plotëson kërkesat metrologjike të përshkruara;

d) pezullon punën e një personi të autorizuar apo të një metrologu të autorizuar dhe fillon procedurën për revokimin e autorizimit, kur këta kryejnë veprimtari, për të cilat ato janë autorizuar, në një mënyrë joprofesionale dhe joligjore;

dh) për të gjitha shkeljet e konstatuara vendos gjoba në përputhje me nenin 64 të këtij ligji.

Neni 51

Informimi i personit të inspektuar

Inspektori informon subjektin për kryerjen e inspektimit, përveç rasteve kur një gjë e tillë cenon efektivitetin e inspektimit.

Neni 52

Mbështetja e punës së inspektorit

1. Personat juridikë apo fizikë, që janë subjekt i inspektimit metrologjik, janë të detyruar të mbështesin kryerjen e inspektimit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet 49 e 50 të këtij ligji dhe të sigurojnë të gjitha kushtet për mbarëvajtjen normale të punës.

2. Vlerësohet se personi juridik apo fizik i inspektuar nuk e ka mbështetur kryerjen e inspektimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse gjatë periudhës së përcaktuar në raport ai nuk e ka mbështetur inspektorin për të inspektuar (kontrolluar) instrumentet matëse ose produktet e paketuara, subjekte të inspektimit, si dhe regjistrat e kërkuar të biznesit dhe dokumente të tjera të nevojshme për të marrë e mbledhur fakte.

3. Personat juridikë apo fizikë, sipas pikës 1 të këtij neni, janë të detyruar që, me kërkesë të inspektorit, të ndërpresin përkohësisht veprimtarinë, nëse nuk ka rrugë tjetër për kryerjen e inspektimit.

4. Pas mbarimit të inspektimit, inspektori mund të kërkojë që personi juridik apo fizik i inspektuar të kryejë disa veprimtari që të vendosen plotësisht faktet, duke përcaktuar një afat kohor, gjatë të cilit duhet të kryhet kjo veprimtari.

Neni 53

Ndjekja e parregullsive të vëzhguara

Në përfundim të inspektimit, inspektori metrolog informon Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për përfundimet dhe masat e marra për shkeljet e vëna re.

Neni 54

Detyrimet për ruajtjen e sekretit

Inspektori metrolog detyrohet të ruajë sekretin profesional për faktet, informacionet dhe aktet, për të cilat është vënë në dijeni, për shkak të detyrës që kryen. Për shkeljet në këtë drejtim mban përgjegjësi, sipas dispozitave ligjore.

Neni 55

Aplikimi i procedurës së përgjithshme administrative

Procedura e inspektimit është subjekt i masave të procedurave respektive administrative, vetëm nëse disa çështje janë rregulluar ndryshe nga ky ligj.

Neni 56
Plumbosja

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përcakton procedurat e pumbosjes për rastet kur, në bazë të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, parashikohet detyrimi për plumbosje.

Neni 57
Pavarësia në punë dhe vendimmarrja

Gjatë inspektimit, inspektori duhet të veprojë i pavarur, të drejtojë procedurën, të lëshojë vendime administrative dhe të marrë masa, në përputhje me të drejtat e detyrat e autoriteteve të përcaktuara nga ky ligj dhe me rregullat e përshtatura për zbatimin e tij.

Neni 58
Vendimi për ndalimin e hedhjes në treg apo heqjes nga tregu

1. Kur parregullsitë e vërejtura nuk janë korrigjuar brenda periudhës kohore të specifikuar dhe para se parapaketimet të hidhen në treg, inspektori metrolog, me miratimin paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, mund të nxjerrë një vendim për ndalimin e hedhjes në treg të parapaketimeve.
2. Kur parregullsitë e vërejtura në instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, që janë në treg ose në përdorim, nuk janë korrigjuar brenda periudhës kohore të specifikuar, inspektori metrolog informon Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe nxjerr vendim për bllokimin, largimin nga tregu ose ndalimin e përdorimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 59
Detyrimi për të informuar organet kompetente

Nëse gjatë inspektimit vërehen shkelje, për të cilat me ligj përgjigjen organe të tjera të administratës shtetërore, atëherë Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë njofton organin përkatës.

Neni 60
Nxjerrja e vendimit verbal

1. Kur kryen veprimtari inspektimi, një inspektor metrolog nxjerr një vendim verbal për ekzekutimin e disa masave të sigurisë, kur ka rrezik që evidencat të fshihen, të zhvendosen ose të shkatërrohen, nëse masa e sigurisë nuk merret menjëherë.
2. Inspektori metrolog urdhëron ekzekutim të menjëhershëm të vendimit verbal. Vendimi verbal duhet të shënohet në aktin e inspektimit.
3. Inspektori metrolog është i detyruar të nxjerrë vendim verbal, në formë të shkruar, menjëherë pas kryerjes së inspektimit.

Neni 61
Apelimi

Kundër vendimit të nxjerrë nga inspektori metrolog mund të apelohet në një komision të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

KREU VII
MASAT FINANCIARE

Neni 62
Mënyrat e financimt të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me të ardhurat nga veprimtaria e saj, mbulon shpenzimet dhe diferenca ndërmjet tyre financohet nga shteti në formën e granteve ose të subvencioneve financiare dhe administrimi i fondeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për institucionet buxhetore.

2. Mënyra e përdorimit të të ardhurave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë nga shërbimet e saj përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për ekonominë, të propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Neni 63
Pagesat dhe tarifat e shërbimeve

1. Kalibrimi, certifikimi i materialeve referuese, miratimi i tipit, verifikimi fillestar, pasardhës dhe jashtë radhe, i instrumenteve matëse, miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe të shisheve, si enë matëse, ekspertiza metrologjike, autorizimi për verifikim dhe shërbim riparimi, si dhe trajnimet e ofruara kryhen kundrejt tarifave të miratuara. Këto tarifa miratohen nga Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për ekonominë. Tarifat janë të njëjta si për subjektet vendase, ashtu dhe ato të huaja, që ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë.

2. Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe laboratorët e etaloneve kombëtare, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, përdorin tarifa të miratuara nga Ministria e Financave.

KREU VIII
KUNDËRVAJTJET DHE SANKSIONET

Neni 64
Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

Kur inspektorët metrologë vërtetojnë se subjekti ka shkelur dispozitat e këtij ligji, kanë të drejtë të vendosin gjobë, sipas pikave 1, 2 e 3 të këtij neni dhe të kërkojnë nga subjekti marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur afat për realizimin e saj.

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Për subjektet e biznesit të vogël 30 000 lekë dhe për subjektet e biznesit të madh 150 000 lekë:

a) përdorimi i njësive matëse në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 11 të këtij ligji;

b) mbajtja në biznesin e vet të një instrumenti matës që nuk është në përdorim dhe nuk është shënuar në mënyrë të dukshme me shenjën "Instrument matës jashtë përdorimit", pika 2 e nenit 20 të këtij ligji;

c) mossigurimi i verifikimit periodik të instrumenteve matëse në intervalet e përshkruara në shkronjën "c" të nenit 21 të këtij ligji;

ç) mosvënia në dispozicion e instrumenteve matëse pas riparimit për verifikim periodik, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 29 të këtij ligji;

d) mosplotësimi i kërkesave për regjistrim, të përshkruara në nenin 38 të këtij ligji.

2. Për subjektet e biznesit të vogël 60 000 lekë dhe për subjektet e biznesit të madh 400 000 lekë:

a) mosmirëmbajtja e rregullt e instrumenteve matëse, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 23 të këtij ligji;

b) prodhimi, importimi dhe hedhja në treg e produkteve të paketuara dhe shisheve, enë matëse, që nuk plotësojnë kërkesat metrologjike dhe nuk kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara, sipas pikës 1 të nenit 37 të këtij ligji;

c) veprimi në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në nenet 42 pika 1 dhe 45 të këtij ligji;

ç) veprimi në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në pikën 3 të nenit 49 të këtij ligji.

3. Për subjektet e biznesit të vogël 100 000 lekë dhe për subjektet e biznesit të madh 750 000 lekë:

a) hedhja në treg dhe vënia në përdorim e instrumenteve matëse në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në pikën 1 të nenit 19 të këtij ligji;

b) përdorimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në pikën 3 të nenit 20 të këtij ligji;

c) veprimi në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në pikën 1 të nenit 21 të këtij ligji;

ç) mosdhënia e informacionit dhe e të dhënave të domosdoshme inspektorit metrolog për të kryer inspektimin, në kundërshtim me dispozitat e pikës 3 të nenit 49 të këtij ligji;

d) veprimi në kundërshtim me dispozitat e nenit 51 të këtij ligji.

Në raste përsëritjeje të së njëjtës kundërvajtje, vlera e gjobës dyfishohet.

Neni 65

Shqyrtimi dhe ankimi

1. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative dhe ankimi i vendimeve bëhen sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", të ndryshuar.

2. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, të dhënë nga inspektori metrolog i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve te Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, i cili brenda 15 ditëve duhet të bëjë shqyrtimin e ankimit.

3. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e dhënies së vendimit.

Neni 66

Ekzekutimi

Gjoba i dërgohet për ekzekutim zyrtarisht brenda 30 ditëve nga data e vendimit të formës së prerë bashkisë ose komunës, ku kundërvajtësi ka vendbanimin ose kryen veprimtarinë kryesore.

Të ardhurat e arkëtuara nga gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 67

Miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, ministria përgjegjëse për ekonominë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 68

Shfuqizimet

Ligji nr.8996, datë 30.1.2003 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)", shfuqizohet.

Neni 69

Hyrja në fuqi

Nenet 35 deri 39, që formojnë pjesën III "Produktet e paketuara dhe shishet, enë matëse" të kreut V "Metrologjia ligjore" të këtij ligji, zbatohen një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 70

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5635, datë 25.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9876, datë 14.2.2008

PËR PRODHIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E BIOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË RINOVUESHME, PËR TRANSPORT

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj synon promovimin e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për zëvendësimin e nënprodukteve të naftës për sektorin e transportit, për të kontribuar në përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra, në kuadër të Protokollit të Kiotos për ndryshimet klimatike, si dhe për të siguruar furnizimin e promovimin me burime energjetike të rinovueshme, nëpërmjet nxitjes e kultivimit të bimëve energjetike, për të mbrojtur mjedisin.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet në veprimtaritë e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, të cilat, në formë të pastër ose të përzier, në përqindje të caktuar me nënprodukte të tjera të rafinimit të naftës bruto, përdoren në sektorin e transportit për motorë me djegie të brendshme.

2. Prodhimi dhe përdorimi i biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose si përzierje, në sektorin e transportit, bëhen kur ato janë në përputhje me standardet europiane, të përshtatura si standarde kombëtare nga organi kombëtar i standardizimit, ose me standardet e tjera të barasvlefshme me to.

Neni 3
Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Biomasa" është fraksionimi i produkteve, mbetjeve dhe mbeturinave të shpërbëshme organike, që përftohen nga veprimtaria bujqësore, ku përfshihen lëndët bimore dhe shtazore, ato pyjore dhe lëndë të ngjashme industriale, si dhe fraksionimi i mbeturinave të shpërbëshme organike industriale, i mbeturinave të shpërbëshme organike rurale dhe urbane.

b) "Biokarburante" janë lëndë djegëse, në trajtë të lëngët ose të gaztë, për transport, të cilat prodhohen nga biomasa dhe veçanërisht:

i) "Biodiezel (diezel me prejardhje organike)" është metil-esteri yndyror dhe etil-esteri i acideve yndyrore metilike, që prodhohen nga vajra bimore (biomasa) ose shtazore dhe nga dhjamëra të

cilësisë së diezelit, si nënprodukt i rafinimit të naftës bruto, për t'u përdorur si biokarburant.

ii) "Bioetanol" është etanoli, që prodhohet nga biomasa ose nga fraksionimi i mbeturinave të shpërbëshme organike, me cilësinë e benzinës, si nënprodukt i rafinimit të naftës bruto, për t'u përdorur si biokarburant.

iii) "Biogaz" është lëndë djegëse e gaztë, që prodhohet nga biomasa ose fraksionimi i mbeturinave organike, industriale dhe urbane, të shpërbëshme, të cilat mund të pastrohen dhe të përmirësohen, në cilësinë e gazit natyror, për t'u përdorur si biokarburant ose gaz druri.

iv) "Biometanol" është metanoli, që prodhohet nga biomasa, për t'u përdorur si biokarburant.

v) "Biodimetileter" është dimetileteri, që prodhohet nga biomasa, për t'u përdorur si biokarburant.

vi) "Bio-ETBE" është Etil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga bioetanoli, për t'u përdorur si biokarburant. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-ETBE-it, që përllogaritet si biokarburant, është 47 për qind e totalit të tij.

vii) "Bio-MTBE" është Metil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga biometanoli, për t'u përdorur si biokarburant. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-MTBE-it, që përllogaritet si biokarburant, është 36 për qind e totalit të tij.

viii) "Biokarburant sintetik" janë hidrokarburet sintetike ose përzierja (mishela) e hidrokarbureve sintetike, që prodhohen nga biomasa.

ix) "Biohidrogjen" është hidrogjeni, që prodhohet nga biomasa dhe/ose nga fraksionimi i shpërbërjes së mbeturinave organike, industriale dhe urbane, për t'u përdorur si biokarburant.

x) "Vajra bimore të pastra" janë vajrat që prodhohen nga bimë vajore energjetike, me shtypje, shtrydhje ose metoda të tjera, në gjendje natyrore ose të përmirësuara, por të pandryshuara kimikisht, kur përshtaten me tipin e motorit ose të pajisjes së përdorur dhe me kërkesat përkatëse të emetimeve të ndotjeve të gazit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) "Lëndë të tjera djegëse të rinovueshme" janë lëndët djegëse të rinovueshme, përveç biokarburanteve, që kanë prejardhje nga burime jofosile të energjisë së rinovueshme, të cilat përdoren për qëllime transporti, sikurse janë energjia e biomasës, e gazit të landfillit, e gazit të impianteve të trajtimit të ujërave urbane dhe të biogazit.

ç) "Prodhimi i biokarburanteve" është përpunimi i lëndëve të para të përshtatshme në impiante të posaçme, për prodhimin e vetë biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

d) "Njësi të prodhimit të biokarburanteve" janë personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

dh) "Impiante për prodhimin e biokarburanteve" janë impiantet e posaçme, ku realizohet prodhimi i biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përfshirë edhe mjediset e nevojshme të magazinimit dhe të shpërndarjes (lëvrimit).

e) "Kultivim energjetik" është prodhimi, importimi ose tregtimi i atyre bimëve, për prodhimin e produkteve, që vlerësohen lëndë djegëse, me bazë organike ose lëndë të para për prodhimin e këtyre lëndëve djegëse.

ë) "Përmbajtja energjetike" është fuqia minimale kalorifike (termogjene) e një lënde djegëse.

2. Biokarburantet e lëngshme ose të gazta dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, të cilat, kur përdoren të pastra ose si përzierje (mishelë) me produkte të tjera të rafinimit të naftës bruto, i zëvendësojnë këto produkte të naftës, quhen, gjithashtu, nënprodukte të naftës, në kuptim të dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, duke iu referuar kategorive respektive të nënprodukteve të naftës që ato zëvendësojnë, sipas grupit të përcaktuar në këtë ligj për këto kategori.

Neni 4
Objektivat

Gjatë ushtrimit të veprimtarive të prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, synohen:

a) nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në sektorin e transportit, nëpërmjet vendosjes së objektivave tregues kombëtarë, të

shprehur në përqindje, për praninë në treg të këtyre produkteve;

b) garantimi i efektshmërisë optimale të punës së motorit, duke respektuar normat e cilësisë dhe ato teknike në prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme;

c) kontributi në mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik;

ç) zhvillimi i qëndrueshëm i sektorëve të bujqësisë dhe të pyjeve;

d) ulja e sasisë së emetimeve të dëmshme, të çliruara në ajër nga veprimtaritë në sektorin e transportit.

KREU II
ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE TË PRODHIMIT DHE TË TREGTIMIT TË BIOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË RINOVUESHME

Neni 5
Njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, organizohen si person juridik, të krijuara në formën e shoqërive anonime, sipas legjislacionit në fuqi, që ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

2. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të prodhimit të biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, bëhen pasi njësitë që i zotërojnë ato të jenë pajisur, sipas dispozitave të këtij ligji, me “leje prodhimi”.

Shfrytëzimi i impiantit të prodhimit të biokarburanteve fillon pas certifikimit të dhënë nga Inspektorati Qendror Teknik, që vëren se janë plotësuar kushtet teknike, të cilat duhet të respektohen gjatë të gjithë afatit të përcaktuar në “lejen e prodhimit”.

3. Njësitë për prodhimin e biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, kanë të drejtë t'i shesin vetë produktet e tyre, në vend ose jashtë tij. Shitja në vend e biokarburanteve ose e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, nga këto njësi, bëhet vetëm në rafineritë e naftës ose në shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me lejet përkatëse nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet.

4. Njësitë për prodhimin e biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e produkteve që prodhojnë.

5. Këto njësi kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëritë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë ose me pakicë të prodhimeve të tyre.

6. Njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, janë të detyruara të paraqesin në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet të dhëna për programin e zhvillimit, si dhe të dhëna periodike për realizimin e veprimtarisë së tyre.

Lloji i të dhënave, forma dhe afatet e dërgimit të tyre nga njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përcaktohen nga kjo ministri.

Ministria përgjigjet për përpunimin dhe botimin e këtyre të dhënave, sipas formës, afateve dhe mënyrës së botimit të përcaktuar.

Neni 6
Përgatitja për tregtim e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, mund të disponohen dhe të tregtohen në formë të pastër ose si përzierje me produktet e përpunimit të naftës bruto, vetëm kur përmbushin standardet teknike, që përcaktohen në legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Ruajtja, magazinimi, transportimi dhe përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, duhet të realizohen në depozita ose impiante magazinimi dhe transportimi të përshtatshme për këto lloj produktesh, të cilat plotësojnë kushtet dhe parametrat teknikë dhe të sigurisë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

3. Përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvecionale të distilimit të naftës bruto realizohet vetëm në instalimet e posaçme dhe në përgjegjësinë e personave të pajisur me "leje koncesioni", për rafineritë e naftës bruto, ose "leje tregtimi", për shoqëritë e tregtimit me shumicë të nënprodukteve të naftës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

4. Rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të nënprodukteve të naftës, të cilat tregtojnë edhe biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse, të rinovueshme, duhet të disponojnë instalime për depozitimin e tyre dhe për realizimin e përzierjes së biokarburanteve me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto. Këto rafineri e shoqëri përgjigjen për funksionimin e këtyre instalimeve, në përputhje me normat teknike, të miratuara nga ministria dhe me masat e mbrojtjes nga zjarri (MNZ).

5. Instalimet, ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto, duhet të jenë të licencuara si magazina doganore, publike ose private, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Veprimtaritë e importimit, të eksportimit dhe të tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierje me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto, realizohen nga njësitë e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, nga rafineritë e përpunimit të naftës bruto, të pajisura me "leje koncesioni" dhe nga shoqëritë e pajisura me "leje tregtimi" për tregtimin me shumicë të nënprodukteve të naftës. Shoqëritë e tregtimit me pakicë të nënprodukteve të naftës, të pajisura me "autorizim", sipas dispozitave ligjore në fuqi, kanë të drejtë të shesin me pakicë biokarburante në formë të pastër ose në formë të përzier me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto, duke zbatuar dispozitat e këtij ligji.

2. Në dokumentacionin përkatës doganor dhe administrativ shoqërues të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose të përzier me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto, duhet të përcaktohet në mënyrë të detyrueshme përqindja e biokarburantit ose e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që përzihet me nënproduktin respektiv të rafinimit të naftës bruto.

3. Zotëruesit e "lejes së tregtimit" për tregtimin me shumicë dhe të "autorizimit" për tregtimin me pakicë të nënprodukteve të naftës, të cilët tregtojnë edhe biokarburante, janë të detyruar që në instalimet e tregtimit ose në pikat e shitjes së tyre të afishojnë, në mënyrë të dukshme dhe të qartë, një shënim të posaçëm për:

a) biokarburantet ose lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme;

b) biodiezelin e përzier me diezel, për lëvizje automjetesh, në përqindje, minimalisht, 5 për qind për vëllim;

c) bioetanolin e përzier me benzinë, në përqindje, minimalisht, 5 për qind për vëllim.

Karakteristikat e shënimit të posaçëm përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, i cili botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 8

Objektivat për përcaktimin e sasisë vjetore minimale në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Në objektivat tregues kombëtarë vjetorë, të shprehur në përqindje, për nxitjen e përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në sektorin e transportit, duhet të përcaktohet përqindja minimale në treg e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të

rinovueshme, në raport me sasinë vjetore të benzinës dhe diezelit të përdorur në sektorin e transportit.

Përllogaritja e përqindjes, për periudhën e plotë vjetore, bëhet në bazë të përmbajtjes energjetike të totalit të lëndëve djegëse (diezelit dhe benzinës) që tregtohen për transport.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë udhëzimin për mënyrën e përcaktimit të sasisë vjetore minimale në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për sektorin e transportit dhe të ministrit përgjegjës për sektorin e hidrokarbureve, përcakton sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit, propozim, i cili, në çdo rast, paraqitet deri më 30 prill të vitit në vazhdim nga ministri përgjegjës për sektorin e hidrokarbureve.

Në rastin kur të dy ministrat nuk veprojnë bashkërisht deri në këtë afat, nisma për propozim i mbetet ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

3. Të dhënat për sasinë minimale të biokarburanteve, që do të përdoren në sektorin e transportit gjatë vitit pasardhës, botohen në media dhe në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet dhe të ministrisë përgjegjëse për transportin.

4. Përcaktimi i sasisë minimale vjetore në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, e cila nuk mund të jetë më e vogël se 3 për qind, do të fillojë nga viti 2010, ndërsa nga viti 2015 e në vazhdim kjo sasi nuk mund të jetë më e vogël se 10 për qind.

5. Në rastet kur sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që ofrohet në treg nga prodhuesit vendas, është më e madhe se sasia minimale vjetore, e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, çdo njësie prodhimi të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, i garantohet të hedhë në treg një sasi minimale vjetore të këtyre produketve, në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1 të këtij neni, e cila nuk kufizon të drejtën e tyre për të tregtuar sasi edhe më të mëdha, në përputhje me kërkesën e tregut.

6. Kur nga programet vjetore të zhvillimit, njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, parashikojnë se prodhimi vjetor vendas i këtyre produkteve nuk mbulon të gjithë sasinë minimale vjetore, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për t'u hedhur në treg, shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me “leje tregtimi” për nënproduktet e naftës, detyrohen të garantojnë furnizimin e tregut me këtë sasi minimale vjetore.

Procedurat për përcaktimin e sasive minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që duhet të garantojë secila shoqëri në treg, jepen në udhëzimin e Këshillit te Ministrave, sipas pikës 1 të këtij neni.

Sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që detyrohet të garantojë çdo shoqëri e tregtimit me shumicë për ta hedhur në treg, për përmbushjen e objektivit për sasinë minimale vjetore, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për këto produkte, nuk kufizon të drejtën e tyre për të tregtuar sasi edhe më të mëdha, në përputhje me kërkesën e tregut për konsumin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

Neni 9

Leja e prodhimit

1. Personat juridikë të organizuar (krijuar) si njësi për prodhimin e biokarburanteve, në përputhje me përcaktimin e pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, pajisen me “leje prodhimi” për të ushtruar veprimtarinë e prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, kur plotësojnë kushtet e procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Leja e prodhimit jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet përpara fillimit të punimeve për ndërtimin e impiantit të prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Leja e prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, jepet për një afat 30 vjet, me të drejtë ripërsëritjeje.

4. Shoqëritë e pajisura me “leje prodhimi” mund të kryejnë edhe veprimtarinë e tregtimit

(importimit dhe/ose eksportimit) të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji, si dhe t'i mbajnë ato brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të kontratave me njësitë e prodhimit të biokarburanteve, me zotëruesit e lejes së koncesionit për rafineritë e naftës, të lejes së tregtimit të llojit "A", për tregtimin e nënprodukteve respektive të rafinimit të naftës, si dhe me konsumatorët e mëdhenj fundorë.

5. Për një konkurrencë transparente, zotëruesit e "lejes së prodhimit" për impiantet e prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, detyrohen të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet analizën e çmimit të prodhimit në fabrikë (ex factory) të këtyre produkteve.

Neni 10
Regjimi tatimor

1. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, që përdoren në sektorin e transportit, si dhe lëndët e para, që përdoren për prodhimin e tyre u nënshtrohen një trajtimi të veçantë tatimor, që i bën ato të konkurrueshme në treg.

Në periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në vitin 2018, niveli i akcizës për këto produkte do të jetë zero.

2. Janë subjekt i një regjimi të veçantë doganor dhe taksash të gjitha makineritë, materialet dhe pajisjet, që shërbejnë dhe janë pjesë e objekteve të prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me të cilat, por pa u kufizuar vetëm në to, nënkuptohen:

a) pajisjet dhe makineritë, që shndërrojnë plehun organik në përmirësues organik të tokës, që përdoret për kultivimin energjetik;

b) pajisjet, materialet dhe makineritë bujqësore, që do të përdoren nga fermerët vendorë për kultivimin energjetik;

c) pajisjet dhe makineritë teknologjike, kryesore dhe ndihmëse, të impianteve të prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

Për periudhën e parë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në vitin 2012, këto pajisje, materiale dhe makineri përjashtohen nga taksa doganore dhe TVSH-ja, që do të thotë se niveli i të cilave do të jetë zero.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të domosdoshëm, që duhet të plotësojnë subjektet, për të përfituar këto lehtësi, sikurse përcaktohet në pikat 1 e 2 të këtij neni.

Neni 11
Sanksionet

1. Kryerja e veprimtarisë së njësive të prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, si më poshtë:

a) shkeljet e pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji, me 800 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

b) shkeljet e pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;

c) shkeljet e pikës 6 të nenit 5 të këtij ligji, me 30 000 lekë deri në 50 000 lekë;

ç) shkeljet e pikës 2 të nenit 6 të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;

d) shkeljet e pikave 2 e 3 të nenit 7 të këtij ligji, me 300 000 lekë deri në 500 000 lekë.

2. Kur veprimtaria ushtrohet pa lejet përkatëse, sipas dispozitave të këtij ligji, subjekti gjobitet me 4 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tri muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të neneve 8, 9 e 10 të këtij ligji.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5636, datë 25.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9877, datë 18.2.2008

PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja "a" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton krijimin, organizimin dhe kompetencat e gjykatave, kushtet dhe procedurat për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, masat disiplinore dhe shkarkimin e tyre, si dhe çështje të tjera të lidhura me funksionimin e gjykatave.

Neni 2
Dita e Drejtësisë

Dita e Drejtësisë është 10 maji.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATAVE

Neni 3
Pushteti gjyqësor

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë.

2. Me ligj mund të krijohen gjykata në fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.

Neni 4
Gjykatat e shkallës së parë

Gjykatat e shkallës së parë janë gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatat e krimeve të rënda.

Neni 5
Gjykatat e apelit

Gjykatat e shkallës së dytë janë gjykatat e apelit dhe gjykatat e apelit të krimeve të rënda.

Neni 6
Organizimi dhe kompetencat e gjykatave

1. Gjykatat e rretheve gjyqësore organizohen dhe funksionojnë në rrethe gjyqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Gjykatat për krimet e rënda organizohen dhe funksionojnë në një ose më shumë rrethe gjyqësore.

3. Kompetencat tokësore të gjykatave dhe qendra e ushtrimit të veprimtarisë për secilën prej tyre caktohen me dekret nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë bën propozimet pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

4. Kompetencat tokësore dhe qendra e ushtrimit të veprimtarisë për gjykatat e apelit caktohen me dekret nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë bën propozimet pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 7
Gjykatat administrative

Organizimi dhe funksionimi i gjykatave administrative rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 8
Numri i gjyqtarëve

Numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe për çdo gjykatë të apelit caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë bën propozimet pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 9
Ndarja e çështjeve gjyqësore

Ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, sipas procedurave të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 10
Gjykata e Lartë

1. Gjykata e Lartë është autoriteti më i lartë gjyqësor, i cili ka juridiksion fillestar dhe

rishikues.

2. Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës së Lartë përcaktohen me ligj të veçantë.

KREU III
KRITERET E REKRUTIMIT DHE TË KARRIERËS SË GJYQTARËVE TË SHKALLËS SË PARË DHE TË APELIT

Neni 11
Kushtet për t'u emëruar gjyqtar

1. Gjyqtar mund të emërohet shtetasi shqiptar, që përmbush kriteret e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të jetë me arsim të lartë juridik;

c) të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të ketë cilësi të larta morale dhe aftësi profesionale.

2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të emërojë deri në 10 për qind të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve persona, të cilët kanë punuar më parë gjyqtarë dhe përmbushin kriteret e shkronjave "a", "b", "ç" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni.

Neni 12
Emërimi i gjyqtarit

1. Gjyqtari në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Gjyqtari i gjykatës për krimet e rënda emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi:

a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në gjykatat e shkallës së parë;

b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;

c) të jetë vlerësuar "Shumë mirë" për aftësi profesionale dy herët e fundit;

ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Gjyqtari i gjykatës së apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi:

a) të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në gjykatat e shkallës së parë;

b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;

c) të jetë vlerësuar "Shumë mirë" për aftësi profesionale dy herët e fundit;

ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

4. Ndërmjet gjyqtarëve që kandidojnë për në gjykatën e krimeve të rënda dhe për në gjykatat e apelit dhe që plotësojnë kushtet e pikave 2 dhe 3 të këtij neni, Këshilli i Lartë i Drejtësisë përzgjedh me pikëzim, sipas kritereve të vjetërsisë në profesion, të rezultateve të punës në vijimësi, në përputhje me renditjen në listën e përhershme, sipas nenit 14 të këtij ligji, si dhe të veprimtarisë shkencore e akademike. Rregulla më të hollësishme për pikëzimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

5. Presidenti, brenda 30 ditëve, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e gjyqtarit të kandidatit të propozuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Pas këtij afati, propozimi vlerësohet i rrëzuar.

Neni 13
Vlerësimi i aftësive profesionale të gjyqtarit

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, të paktën një herë në tre vjet, bën vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit, në përputhje me vendimin e miratuar prej tij për kriteret e vlerësimit.

2. Vlerësimi i aftësive profesionale është:

a) "Shumë mirë";

b) "Mirë";

c) “Pranueshëm”;

ç) “I paaftë”.

3. Vlerësimi “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

4. Në rastin kur gjyqtari është vlerësuar “Pranueshëm”, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, brenda një viti, bën rivlerësimin e tij.

Neni 14

Lista e përhershme e renditjes së gjyqtarëve

1. Për efekt të karrierës profesionale, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mban një listë të përhershme të renditjes së gjyqtarëve për rezultatet e punës në vijimësi, e cila përditësohet çdo gjashtë muaj.

2. Renditja e gjyqtarëve në listën e përhershme bëhet sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 15

Betimi i gjyqtarëve

1. Para fillimit të detyrës, gjyqtarët bëjnë betimin si më poshtë:

“Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”.

2. Betimi i gjyqtarëve të sapoemëruar bëhet me një ceremoni publike para Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 16

Kushtet dhe emërimi i kryetarit të gjykatës

1. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në bazë të konkurrimit.

2. Kandidatët për kryetar të gjykatës së shkallës së parë dhe për kryetar të gjykatës së apelit duhet të plotësojnë këto kritere:

a) të kenë punuar jo më pak se katër vjet si gjyqtarë në gjykatat e të njëjtit nivel ose të niveleve më të larta;

b) të jenë vlerësuar “Shumë mirë” nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dy herët e fundit;

c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

ç) të kenë aftësi organizuese dhe menaxhuese;

d) të mos jenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 17

Qëndrimi në detyrë, shkarkimi dhe mbarimi i mandatit të kryetarit të gjykatës

l. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit qëndrojnë në detyrë për katër vjet, me të drejtë riemërimi, sipas procedurave dhe kritereve të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji.

2. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit shkarkohen kur nuk përmbushin detyrat e nenit 18 të këtij ligji.

3. Mandati i kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe i kryetarit të gjykatës së apelit mbaron para afatit:

a) kur jep dorëheqjen;

b) në rastet e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji;

c) kur është në pamundësi fizike të ushtrimit të detyrës për më shumë se 3 muaj;

ç) kur zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

4. Shkarkimi i kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe i kryetarit të gjykatës së apelit bëhet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur kërkohet me shkrim nga jo më pak se 5 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ose nga Ministri i Drejtësisë.

5. Mbarimi i mandatit të kryetarit të gjykatës deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pas kërkesës së motivuar të çdo anëtari të këtij Këshilli.

Neni 18
Kompetencat e kryetarit të gjykatës

l. Një herë në çdo dy vjet kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit përcaktojnë shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma dhe seksione për vitet në vijim. Kjo ndarje nuk e pengon kryetarin e gjykatës që, gjatë vitit kalendarik, për nevoja pune, të komandojë gjyqtarë për të gjykuar në një seksion tjetër.

2. Kryetari i gjykatës ku ndodhet qendra e veprimtarisë së rrethit gjyqësor, që ka në kompetencë tokësore dy ose më shumë qendra të ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, cakton me short gjyqtarët që do të gjykojnë në to, sipas një grafiku të veçantë, në varësi të numrit dhe karakterit të çështjeve.

3. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit, përveç sa më sipër, kryejnë edhe këto detyra:

a) përfaqësojnë gjykatën në marrëdhëniet me të tretët;

b) bëjnë ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues;

c) në fillim të çdo muaji, bëjnë planifikimin e gjyqtarëve për gjykimet me objekt vlerësim i arrestit në flagrancë apo ndalimit, caktimin e masave të sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër gjatë fazës së hetimit, sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin;

ç) organizojnë diskutime për çështje të natyrës juridike, bazuar në përgjithësimin e përvojës së gjykimit, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave të tjera, vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, aktet e kontrollit dhe inspektimit të ushtruara nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë;

d) mbikëqyrin respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe planifikimin e çështjeve gjyqësore për qëllime të vlerësimit profesional;

dh) marrin kontakt me ekipet e kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë apo të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, njihen me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijojnë atyre mundësi në ushtrimin e detyrës;

e) mbikëqyrin disiplinën në punë të gjyqtarëve;

ë) bashkërendojnë punën me Shkollën e Magjistraturës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për çështje të ngritjes profesionale të gjyqtarëve;

f) kujdesen për çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë;

g) kryejnë detyra të tjera në funksion të drejtimit administrativ të gjykatës, të parashikuara në aktet ligjore ose nënligjore në fuqi.

4. Në mungesë të kryetarit, detyrat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni kryhen nga një gjyqtar i autorizuar prej tij.

Neni 19
Regjistri i gjyqtarëve

Pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë krijohet regjistri i gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, i cili përmban të paktën:

a) gjenealitetet e çdo gjyqtari;

b) të dhënat e edukimit të tij akademik;

c) datën e emërimit;

ç) pjesëmarrjen në kualifikime dhe trajnime;

d) vendime disiplinore, nëse ka;

dh) vlerësimin e tij si gjyqtar;

e) të dhëna për karrierën gjyqësore.

KREU IV
STATUSI I GJYQTARIT

Neni 20
Palëvizshmëria e gjyqtarit

Gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra, përveç rasteve kur:
a) jep dorëheqjen;
b) mbush moshën 65 vjeç, të daljes në pension;
c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
ç) shkarkohet nga detyra.

Neni 21
Transferimi dhe delegimi i gjyqtarëve

1. Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor.

2. Në rastet kur një gjykatë nuk ka mundësi të shqyrtojë një ose disa çështje brenda afateve të arsyeshme kohore, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me kërkesën e motivuar të kryetarit të gjykatës përkatëse, mund të delegojë gjyqtarë nga gjykata të tjera.

Delegimi i gjyqtarëve bëhet vetëm për çështje të caktuara.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve, duke pasur parasysh afërsinë gjeografike, ngarkesën individuale të gjyqtarëve dhe përkatësinë e tyre në seksione.

Neni 22
Papajtueshmëritë me detyrën e gjyqtarit

Gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private ose politike.

Neni 23
Kufizime për shkak të detyrës

1. Gjyqtarit i ndalohet edhe:

a) të bëjë pjesë në parti politike, ose të marrë pjesë në veprimtari me karakter politik;

b) të marrë pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi;

c) të jetë ekspert ose arbitër në arbitrazh;

ç) të bëjë deklarata në publik në lidhje me proceset;

d) të bëjë të ditur mendimet që janë dhënë gjatë seancave të gjykimit, që akoma nuk kanë marrë formën e një vendimi;

dh) të bëjë deklarata në publik për çdo gjë tjetër që cenon paanshmërinë në proces;

e) të bëjë grevë.

2. Gjyqtari duhet të ruajë dinjitetin e tij, duke mos lejuar veprime që kompromentojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tij në shoqëri.

Neni 24
Të drejta dhe përfitime për shkak të detyrës

1. Gjyqtari ka të drejtë të ketë mbrojtje të veçantë nga shteti për vete, familjen dhe pronën, kur një gjë të tillë e kërkon ai vetë, për rrethana serioze, që i kërcënojnë jetën, familjen dhe pronën, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht. Gjyqtari i ngarkuar me kryerjen e detyrave të ngutshme në muajin gusht, lejen vjetore e bën në një periudhë tjetër, duke përfituar pesë ditë shtesë.

3. Gjyqtari që kryen detyra të ngutshme në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, përfiton shtesë page në masën 50 për qind të pagës së tij ditore.

4. Gjyqtarët mund të krijojnë shoqata ose organizata për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre, si dhe për ngritjen profesionale.

Neni 25

Solemniteti i gjykimit

1. Gjyqtari, gjatë gjykimit të çështjes, duhet të respektojë solemnitetin e gjykimit dhe të mbajë veshje të posaçme.

2. Rregullat në lidhje me solemnitetin e gjykimit dhe veshjen përcaktohen me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 26

Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë

l. Paga bazë e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit.

2. Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind.

3. Paga bazë e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind.

4. Paga bazë e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind dhe për drejtimin e gjykatës shtohet 10 për qind.

Neni 27

Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së apelit

l. Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit.

2. Paga e bazë e gjyqtarit të gjykatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 70 për qind të pagës të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind.

3. Paga bazë e kryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind.

4. Paga bazë e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe e kryetarit të gjykatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind dhe për drejtimin e gjykatës shtohet 10 për qind, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të

Gjykatës së Lartë.

Neni 28
Ruajtja e statusit të gjyqtarëve që shërbejnë në institucione të tjera

1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës.

2. Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave.

3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.

4. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29
Përgjegjësia penale e gjyqtarit

1. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë ose gjyqtari i gjykatës së apelit mund të ndiqet penalisht, sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Autorizimi për fillimin e procedimit penal bëhet me miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Gjyqtari mund të ndalohet ose arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

3. Në rastin kur ndaj një gjyqtari jepet autorizimi për fillimin e procedimit penal, ai pezullohet nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë.

4. Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij të mëparshme dhe të marrë pagën e plotë që nga koha e pezullimit.

Neni 30
Kufizimi i përgjegjësisë civile të gjyqtarit

Gjyqtari nuk përgjigjet në një padi civile, e cila lidhet me kryerjen e detyrave të tij profesionale, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

KREU V
PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET DISIPLINORE, MASAT DISIPLINORE DHE PROCEDIMI DISIPLINOR I GJYQTARIT

Neni 31
Përgjegjësia disiplinore

1. Gjyqtari i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në rastet dhe me garancitë e parashikuara në

ligj.

2. Gjyqtari ka përgjegjësi disiplinore për shkelje të ligjit dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji.

Neni 32
Shkeljet disiplinore

1. Shkeljet e disiplinës së gjyqtarit ndahen në:

a) shumë të rënda;

b) të rënda;

c) të lehta.

2. Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë:

a) aktet dhe sjelljet e ndaluara nga neni 23 i këtij ligji;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustifikuar dhe e vijueshme për 7 ditë ose më shumë, kur mungesa ka passjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;

c) shkelja e pajustifikuar dhe e përsëritur e dispozitave urdhëruese procedurale, kur këto shkelje kanë passjellë ose mund të sillnin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;

ç) refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive;

d) përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat i jepen për shkak të detyrës;

dh) mosbërja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi, kur kjo është e detyrueshme, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile;

e) mungesa absolute e arsyetimit në vendimin gjyqësor;

ë) refuzimi i zbatimit të masës disiplinore;

f) moszbatimi i vendimit unifikues, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave, këto vendime janë të detyrueshme;

g) kryerja e një shkeljeje të rëndë, kur gjykatësi ka qenë më parë i dënuar për një shkelje tjetër të rëndë, e cila nuk është parashkruar ose shuar;

gj) akte dhe sjellje të tjera të rënda që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

3. Janë shkelje të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë:

a) zvarritja e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, kur zvarritja ka passjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;

b) vonesa e përsëritur për fillimin e seancës gjyqësore;

c) braktisja e punës ose mungesa e pajustifikuar dhe e vijueshme për 3 ditë apo më shumë, kur mungesa ka passjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;

ç) ndërhyrja ose çdo lloj ndikimi tjetër në ushtrimin e detyrës të një gjyqtari tjetër;

d) mosrespektimi i rregullave të solemnitetit, sipas nenit 25 të këtij ligji;

dh) shkelja e normave të etikës në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, kolegët, kryetarin e gjykatës, stafin e administratës gjyqësore, ekspertët, prokurorët, avokatët;

e) përdorimi i shprehjeve të pahijshme e ofenduese në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor. Në këto raste Këshilli i Lartë i Drejtësisë vihet në lëvizje përmes një ankese të palëve në proces;

ë) bërja publike e akteve ose dokumenteve zyrtare, të dhënave apo regjistrimeve me karakter sekret ose konfidencial;

f) pengimi i funksioneve të inspektorateve në veprimtarinë e tyre të ligjshme;

g) kryerja e një shkeljeje të lehtë, kur gjyqtari ka qenë më parë i dënuar me vërejtje me paralajmërim për një shkelje tjetër të lehtë, e cila nuk është parashkruar ose shuar;

gj) akte dhe sjellje të tjera të rënda që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

4. Janë shkelje të lehta aktet dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më

poshtë:

a) vonesa në fillimin e seancës gjyqësore;

b) mungesa e pajustifikuar në punë deri në 3 ditë;

c) shoqërimi me palët pjesëmarrëse gjatë periudhës së gjykimit;

ç) akte dhe sjellje të tjera që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

Neni 33

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.

2. Masat disiplinore janë:

a) vërejtje;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët;

ç) dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij;

d) shkarkim nga detyra.

3. Për shkeljet shumë të rënda, të parashikuara në nenin 32 pika 2 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën "d" të pikës 2 të këtij neni.

4. Për shkeljet e rënda, të parashikuara në nenin 32 pika 3 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 2 të këtij neni.

5. Për shkeljet e lehta, të parashikuara në nenin 32 pika 4 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të këtij neni.

6. Për efekt të procedimit disiplinor, masat disiplinore të rënda shlyhen brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore, ndërsa masat disiplinore të lehta shlyhen brenda 2 vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Neni 34

Procedimi disiplinor i gjyqtarit

1. Të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë e ka Ministri i Drejtësisë.

2. Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes.

Neni 35

Të drejtat e gjyqtarit në procedimin disiplinor

1. Gjyqtari, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor, ka të drejtë:

a) të informohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar për faktet e akuzuara, shkeljet dhe sanksionet që mund të vendosen, si edhe për inspektorin që i caktohet;

b) të formulojë pretendime dhe kërkesa;

c) të njihet me dokumentet e procedimit disiplinor dhe të depozitojë prova të mjaftueshme;

ç) të ketë asistencën e një avokati ose kolegu gjatë procedimit dhe të dëgjohet në prani të tij.

2. Ndaj gjyqtarit nuk mund të zbatohen rregulla të reja dhe më rënduese në një procedim që ka nisur më parë.

3. Gjyqtari nuk mund të procedohet për të njëjtat akte dhe sjellje, për të cilat është gjykuar në një proces disiplinor të mëparshëm.

Neni 36
Ankimi ndaj masave disiplinore

1. Ndaj vendimit të shkarkimit nga detyra, gjyqtari ka të drejtë të ankohet, brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit, në Gjykatën e Lartë, e cila vendos me kolegje të bashkuara.

2. Për masat e tjera disiplinore, ankimi bëhet në Gjykatën e Apelit, Tiranë.

KREU VI
ADMINISTRIMI I SHËRBIMEVE NË GJYKATË

Neni 37
Kancelari i gjykatës

1. Kancelari i gjykatës drejton dhe përgjigjet për shërbimet ndihmëse në gjykatë.

2. Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë.

3. Kancelar emërohet juristi, i cili ka përvojë pune jo më pak se pesë vjet në këtë profesion.

4. Kancelari përfiton pagë dhe leje të pagueshme vjetore të njëjtë me atë të gjyqtarit të gjykatës përkatëse ku ushtron funksionet.

Neni 38
Kompetencat e kancelarit

Kancelari i gjykatës ka këto kompetenca kryesore:

a) emëron dhe shkarkon personelin e sekretarisë gjyqësore dhe personelin administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës;

b) mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar;

c) ndjek ecurinë e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara në sekretarinë gjyqësore, në përputhje me afatet procedurale të parashikuara në ligj;

ç) shpall listën e ekspertëve të licencuar, sipas fushave përkatëse;

d) mbikëqyr disiplinën në punë të punonjësve të administratës gjyqësore;

dh) siguron mjedis të veçantë brenda gjykatës për studimin e dosjeve gjyqësore nga avokatët, prokurorët, ekspertët, përfaqësuesit e palëve ose personat që e kanë këtë të drejtë;

e) miraton orarin e shërbimeve që përmbushen nga strukturat e administratës gjyqësore dhe përcakton orarin e pritjes së popullit.

Neni 39
Administrata gjyqësore

Shërbimet ndihmëse në gjykatë kryhen nga sekretaria gjyqësore, degët dhe sektorët e administratës, të ekonomisë, financës, informatizimit, regjistrimit dhe ruajtjes së dokumenteve.

Neni 40
Buxheti i pushtetit gjyqësor

1. Pushteti gjyqësor ka buxhet të veçantë, i cili administrohet prej tij, sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë.

2. Fondet ose donacionet që mund t'u jepen gjykatave, kalojnë nëpërmjet zyrës që administron buxhetin e gjyqësorit.

Neni 41
Rendi dhe siguria në gjykatë

1. Për të garantuar rendin dhe sigurinë, pranë gjykatave organizohet shërbim i vijueshëm i Policisë së Shtetit, i cili vepron sipas urdhrave të kryetarit të gjykatës.

2. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat për garantimin e rregullit dhe të sigurisë në gjykata.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42
Riorganizimi gjyqësor

1. Pavarësisht nga pika 1 e nenit 21 të këtij ligji, kur një gjykatë mbyllet ose numri i gjyqtarëve zvogëlohet, për shkak të riorganizimit gjyqësor, gjyqtari mund të transferohet në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose më të ulët. Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28 pika 1 të këtij ligji, duke përfituar pagën e gjyqtarit.

2. Në rast se transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, është i pamundur, gjyqtari futet në një listë të veçantë dhe ka përparësi emërimi në vendin më të parë vakant që krijohet. Deri në periudhën e emërimit ai merr 100 për qind të pagës.

3. Në rast se transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, refuzohet apo gjyqtari i përfshirë në listën e veçantë, sipas pikës 2 të këtij neni, ushtron veprimtari, e cila është e papajtueshme me statusin e gjyqtarit, atëherë gjyqtari shkarkohet nga detyra.

Neni 43
Dispozitë kalimtare

1. Çështjet, të cilat, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shqyrtohen nga seksionet penale ushtarake ose gjykata e apelit ushtarak, do të përfundojnë po nga këto seksione apo gjykata.

2. Deri në kryerjen e dy vlerësimeve për aftësitë profesionale, sipas nenit 13 të këtij ligji, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që konkurron për gjyqtar në gjykatën e apelit ose në gjykatat për krimet e rënda, i nënshtrohet një vlerësimi me procedurë të përshpejtuar.

3. Mandati i kryetarëve të gjykatave, që janë në detyrë në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që kanë shërbyer në detyrë më shumë se 4 vjet, quhet i përfunduar me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

4. Kryetarët e gjykatave, që janë në detyrë në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që kanë shërbyer si të tillë për më pak se 4 vjet, vijojnë të shërbejnë deri në plotësimin e këtij afati.

5. Nenet 26 dhe 27 të këtij ligji i fillojnë efektet financiare më 1 janar 2009. Këto dispozita mbi pagat nuk cenojnë pagën aktuale që përfiton gjyqtari në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

6. Statusi, organizimi dhe funksionimi i administratës gjyqësore do të jenë pjesë përbërëse e këtij ligji.

Neni 44
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 24 pika 1 dhe nenit 41 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Lartë i Drejtësisë që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet normative në zbatim të neneve 9, 12 pika 4, 13 pika 1, 14 pika 2, 21 pika 2 dhe 25 pika 2 të këtij ligji.

Neni 45
Shfuqizime

Ligji nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 46
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5647, datë 28.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 600 lekë
2. REGJISTRAT E NOTERISË 1000 lekë

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë

- Vendime të Gjykatës Kushtetuese 700 lekë
- Vendime të Gjykatës së Lartë 1000 lekë
- Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil 200 lekë
- Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave 273 lekë
- Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme
  (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)

Hyri në shtyp më 29.2.2008
Doli nga shtypi më 29.2.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë